



Data: 03.05.2019

Ref.: 687/18D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 64-të, të mbajtur më 08 mars 2019, mori:

## V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për akreditim e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Filozofik, Nr.1439/18, datë 29.10.2018 për programin e studimit:
  - 1.1 Psikologji komuniteti dhe klinike, MA, 120 ECTS.
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Filozofik (tash e tutje Fakulteti Filozofik) ka parashtruar kërkesë (Nr.1439/18, datë 29.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për akreditim/riakreditim të tri programeve të studimit si në vijim: Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci, MA, 120 ECTS; Psikologji komuniteti dhe klinike, MA, 120 ECTS, dhe Arkivistikë, MA, 120 ECTS.

Bazuar në Nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KSHC në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e Fakultetit Filozofik, dhe pas analizës së dokumentacionit të stafit akademik bazuar në pikën 1. 2 të këtij Neni, ku thuhet, "Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike së bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së", erdhi në përfundim se programi i studimit, Psikologji komuniteti dhe klinike, MA, 120 ECTS, nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim nga KShC.

Sipas Nenit 26, pika 5. 3. 4 e UA për Akreditim (15/2018, datë 28. 09. 2018): "Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit



studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.

KSHC ne mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019 ka aprovuar aplikacionin për këtë program të studimit. Ndërsa në të njëjtën mbledhje ka tërhequr akreditimin për programin Psikologji, BA, 180 ECTS, me arsyetimin e mungesës se stafit akademik nga fusha e programit të studimit. Në afatin ligjor Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik (04.03.2019) ka parashtruar ankesë, më ç ‘rast ka paraqitur staf akademik të fushës së studimit, staf ky i cili tashme ishte aprovuar me programin e studimit Psikologji komuniteti dhe klinike, MA, 120 ECTS, në mbledhjen e 61-të KSHC të mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019.


Sipas ankesës së këtij institucioni, stafi i aprovuar me programin, Psikologji komuniteti dhe klinike, MA, 120 ECTS, bartët në programin Psikologji, BA, 180 ECTS, ndërsa tërhiqen nga procedura e akreditimit për programin e studimit, Psikologji komuniteti dhe klinike, MA, 120 ECTS, në mungesë të stafit akademik.

Bazuar në atë çka u tha me lartë, KSHC në mungesë të stafit akademik për këtë program të studimit sipas kriterëve ligjore, pas zhvendosjes së këtij stafi në programin Psikologji, BA, dhe bazuar në kërkesën e Universitetit të Prishtinës, Fakulteti Filozofik për tërheqjen nga procedura e akreditimit për programin e studimit, Psikologji komuniteti dhe klinike, MA, 120 ECTS, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik;
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

